



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 239/2 prot.,

Datë 01.02.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KOMBEAS” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur Punë*” me nr. REF-91817-12-21-2023, me objekt: “*Rikonstrukcion shkolla 9 vjeçare "Demokracia"*”, me fond limit 47.500.000 (dyzet e shtatë milion e pesëqind mijë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “KOMBEAS” SHPK me NIPT K88103301J dhe adresë Fshati Prozhme, Rruga Dod Lleshit, ne pasurine me nr. 6/50, Zona Kadastrale 3441, Kurbin.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Durrës me adresë Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.

Në datën 01.02.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3783 dhe me nr. 239/2024 prot., datë 01.02.2024 e operatorit ekonomik “KOMBEAS” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KOMBEAS” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “KOMBEAS” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

*oferta e paraqitur nga KOMBEAS, duke qenë në kushtet e ofertës anomalisht të ulët nuk është bërë sipas kërkesave të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 93, Oferta anomalisht e ulët, duke mos dhënë shpjegime për anën ekonomike sipas kritereve: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore. Operatori ekonomik KOMBEAS nuk ka asnjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm i cili do të përlligjte këtë ofertë, si dhe nuk provon përpara autoritetit kontraktor asnjë zgjidhje teknike e cila mund ta favorizojë për realizimin e kontratës. Gjithashtu, në përgjigje të kërkesës për argumentim oferte anomalisht të ulët, janë cituar edhe disa kontrata afatgjatë furnizimesh me operatorë të ndryshëm, por pa i dokumentuar këto kontrata. Përveç kësaj, nuk ka paraqitur as analizë teknike për zërat e preventivit objekt-prokurimi, në përmbushje të gërmës a) të nenit 93 të LPP ku flitet për anën ekonomike të metodës së ndërtimit. Oferta anomalisht e ulët e paraqitur nga operatori ekonomik KOMBEAS jo vetëm nuk justifikohet sipas kërkesave të nenit 93 të LPP-së por rrezikon seriozisht që të mos realizojë me sukses objektin e kontratës. KVO vendos që ofertuesi KOMBEAS të mos kualifikohet.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 01.02.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**